

DEKLARATË MBI SITUATËN E ZJARREVE NË SHQIPËRI

Tiranë, më 14 gusht 2025

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural ndjek me shqetësim dhe dhimbje të thellë situatën e rëndë të zjarreve që kanë përfshirë disa zona të vendit. Humbja e jetëve, dëmtimi i pronave, shkatërrimi i pyjeve, kullotave dhe biodiversitetit janë fatkeqësi e madhe që prek drejtpërdrejt banorët dhe komunitetet e këtyre zonave, dhe të gjithë ne. ANRD dhe organizatat anëtare shprehin solidaritetin e plotë me familjet dhe komunitetet e prekura këtë moment të vështirë.

Këto situata të rënda tregojnë edhe një herë se komunitetet rurale, përveç sfidave të përditshme sociale dhe ekonomike, mbeten jashtëzakonisht të cenueshme ndaj fatkeqësive natyrore si zjarret, përmbytjet, breshëri apo thatësisirat. Mungesa e infrastrukturës së duhur, e mjeteve moderne për shuarjen e zjarreve, e personelit të trajnuar dhe planeve parandaluese të mirëkoordinuara i bën këto zona edhe më të pambrojtura.

ANRD kërkon nga Qeveria dhe institucionet përgjegjëse operacionalizimin e një mekanizmi të qartë dhe transparent për vlerësimin e dëmeve dhe dëmshpërblimin e banorëve të prekur nga zjarret. Ky mekanizëm duhet të garantojë që humbjet materiale dhe ekonomike të vlerësohen pa vonesë, në mënyrë të drejtë dhe të dokumentuar, duke u siguruar komuniteteve të prekura mbështetjen dhe mjetet e nevojshme për rimëkëmbje.

Gjithashtu, ANRD kërkon nga institucionet publike përgjegjëse që të forcojnë menaxhimin e emergjencave, të përmirësojnë infrastrukturën zjarrfikëse dhe të garantojnë koordinim efektiv në të gjitha nivelet e qeverisjes. Bashkitë e vendit kanë nevojë urgjente të forcojnë shërbimin zjarrfikës me mjete dhe pajisje bashkëkohore, shtim të personelit të trajnuar dhe përfshirje të teknologjive moderne për ndërhyrje të shpejtë. Është e nevojshme rishikimi i politikave mbi administrimin e pyjeve, forcimi i masave parandaluese dhe ndëshkime të ashpra për zjarrvënësit e qëllimshëm.

ANRD dhe organizatat e veta anëtare, me shtrirje në gjithë Shqipërinë dhe lidhje të forta me komunitetet rurale, shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar me institucionet publike, njësitë e vetqeverisjes vendore, organizata të tjera të sektorit civil dhe komunitetet rurale për sa më poshtë:

- Monitorimin e procesit të vlerësimit të dëmeve dhe të dëmshpërblimit, mbledhjen e evidencave dhe kërkesën e llogarisë nga institucionet përgjegjëse për zbatimin efektiv dhe të drejtë të tyre.
- Ofrimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe trajnuese të vazhdueshme për fermerët, banorët e komuniteteve rurale, veçanërisht ato në risk të lartë për zjarre, rreth masave parandaluese dhe eprimet e para në rast të emergjencave.
- Nxitjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm me strukturat e pyjeve, prefekturat, njësitë e mbrojtjes civile dhe komunitetit dhe shoqata të sektorit civil.
- Advokaci për politika mbështetëse për fermerët, blegtorët dhe barinjtë që praktikojnë praktika të qëndrueshme të menaxhimit të kullotave, pa përdorur djegien.
- Advokaci e vazhdueshme për integrimin e vlerësimit të politikave në funksion të interesit të zonave rurale në të gjitha politikat publike të vendit si standard i detyrueshëm në hartimin dhe zbatimin e tyre në Shqipëri. Kjo me qëllim çdo politikë dhe program të marrë parasysh nevojat

specifike të zonave rurale, duke sjellë përfitime, mbështetje dhe mbrojtje më të madhe për këto komunitete.

ANRD u bën thirrje të gjithë qytetarëve që ndodhen në zonat e rrezikuara të ndjekin udhëzimet e autoriteteve, të ruajnë jetën mbi gjithçka dhe të kontribuojnë aty ku është e mundur, pa vënë në rrezik sigurinë e tyre. Vetëm përmes solidaritetit, veprimit të përbashkët dhe politikave të përgjegjshme mund të tejkalojmë këtë situatë të vështirë dhe të rikthejmë gjallërinë e komuniteteve rurale dhe të mbrojmë natyrën.

**** Kjo deklaratë është përgatitur dhe miratuar nga organizatat anëtare të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, duke reflektuar angazhimin e përbashkët për mbrojtjen e komuniteteve rurale, natyrës dhe biodiversitetit në Shqipëri. Organizatat anëtare janë renditur sipas rendit alfabetik.*

1. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
2. ADAD Malore (Shoqata e Zhvillimit Bujqësor të Rretheve Malore)
3. Agjencia e Zhvillimit Rajonal Lezhë
4. AGRIEN Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore (AGRIEN)
5. Agrinas Ersekë
6. AgriNet Albania
7. AGROPUKA
8. Bashkëpunimi për Zhvillimin e Vendeve në Emergjencë (COSPE)
9. Creative Bussiness Solutions (CBS)
10. Diakonia Agapes
11. Dorcas Aid International Albania
12. Federata Bujqësore Elbasan
13. Fondacioni CESVI Onlus (CESVI)
14. Gratë në Bujqësinë e Qëndrueshme (WSA)
15. GVV “Egnatia”
16. GVV “Mokër-Gorë”
17. GVV “Kolonja e Gjellbër”
18. GVV “Pro Përmet”
19. Help Shqipëri
20. Instituti i Bujqësisë Biologjike (IBB)
21. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
22. Instituti për Paqe, Zhvillim dhe Inovacion (ACLI-IPSIA)
23. Klubi i Sipërmarrësve të Rinj (KSR)
24. Koordinimi i Organizatave për Shërbim Vullnetar (COSV)
25. Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore
26. Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale (RASP)
27. Qendra Agritra-Vizion
28. Qendra e Rinisë Rurale (RYH)
29. Qendra Konsumatori Shqiptar
30. Qendra për Zhvillim dhe Integrim (CDI)
31. Shoqata “Integrimi” Tropojë
32. Shoqata “Aleanca Alpeve Shqiptare”
33. Shoqata e Përdoruesve të Burimeve Natyrore Velçan
34. Shoqata Ishmi
35. Shoqata mjedisore “Çajupi”
36. Shoqata për Integrimin Gjinnor (FGIA)
37. Vizion i Gjellbër
38. Volontari nel Mondo (RTM)
39. Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillimin (VIS)
40. World Vision Albania